



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 6

Prishtinë, më 04.12. 2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I Mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe
Mbiqëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës**

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mosilović, zëvendëskryetar i dytë, Ismet Beqiri, Blerim Kuçi, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

Mungoi: Ramiz Kelmendi, Xhelal Sveçla dhe Drita Millaku

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Gramoz Paqarada-KDI, Dhurata Kryeziu-OSBE, Njomza Arifi-praktikante.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Haxhi Shala, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e komisionit e mbajtura me datë 07.11.2017 dhe 14.11.2017;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-214;
4. Shqyrtimi i Projektligjit 06/L-014 për Infrastrukturë Kritike;
5. Të ndryshme.

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e komisionit e mbajtura me datë 07.11.2017 dhe 14.11.2017.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-214.

Kryetari, theksoi se projektligji ka kaluar në lexim të parë në seancën plenare dhe tashmë mbetet nga Komisioni të formoj grupet punuese për shqyrtimin e këtij projektligji. Propozoi që z.Fatmir Xhelili, të jetë kryesues i grupit punues.

Rexhep Selimi, propozoi që të krijohet vetëm një grup punues dhe në të, të përfshihen kushdo që dëshiron të kontribuoj dhe të trajtohen të dy projektligjet që janë në procedurë.

Fatmir Xelili, theksoi që pajtohet me propozimin e z.Selimi për një grup punues, pasi Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror ka vetëm dy pika që duhet trajtuar, ndërsa Projektligji për Infrastrukturë kritike do të ketë më shumë punë. Gjithashtu propozoi që të vazhdohet me një dinamik të shpejt, në mënyrë që të procedohen sa më shpejt në seancë për lexim të dytë.

Rexhep Selimi, shprehi gatishmërinë për të qenë pjesë e grupit punues për këto projektligje. Gjithashtu shtoi se edhe z.Xhelal Sveçla ka shprehur interesin të jetë pjesë e grupit punues.

Ismet Beqiri, propozoi z.Ramiz Kelmendi nga Grupi Parlamentar i LDK-së të jetë pjesë e grupit, duke shprehur gatishmërinë edhe për kontributin e tij nëse do të ketë nevojë.

Zoran Mojsiloviq, shprehi gatishmërinë për të qenë pjesë e grupit punues për të dy projektligjet.

Blerim Kuçi, lidhur me Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, theksoi që ka vërejtur se është mundësia për rregullimin e disa çështjeve me akte nënligjore, pasi çështjet që sipas tij janë rregullua me këtë projektligj, më vonë mund të jenë pengesë. Për këtë arsye theksoi që, nuk e kupton pse janë futur në ligj disa elemente, që sipas tij janë të pa rëndësishme. Për këtë arsye kërkoi që të shikohet mirë se çfarë mund të mbetet në projektligj dhe çfarë mund të rregullohet me akte nënligjore. Ndërsa duke iu referuar Neni 40 të këtij projektligji, theksoi se duket të jetë problematik, pasi ka bërë problem në procesin e demarkimit, pasi ka të bëjë me emërimin e anëtarëve të Komisionit Shtetëror për shënjimi dhe mirëmbajnë e kufirit shtetëror.

Duke iu referuar çështjes së demarkacionit me Malin e Zi, theksoi që Komisioni që ka marrë pjesë për shënjimin e kufirit me Malin e Zi, nuk kanë pas autorizimet me këtë ligj, pasi nuk i jep autorizimin asnjëri Komisioni, qoftë “Komisionit Meha” apo “Komisionit Bulliqi” të bëjë shënjimin e kufirit, asi kjo e drejtë u takon vetëm pas marrëveshjeve ndërkombëtare.

Për këtë arsye kërkoi që të kërkohet një interpretim ligjor, nëse ky Komision ka autorizim ligjor të ushtroj këtë funksion.

Rexhep Selimi, lidhur me zbatimin e ligjit, theksoi që deri sa të miratohet ligji i ri, zbatim gjen ligji aktual, duke theksuar që duhet të kërkohet interpretim i veçantë për ligjin që është në fuqi nga ana e grupit punues të Komisionit. Ndërsa sa i përket legjislacionit sekondar theksoi që nga përvoja e kaluar është lënë mundësi për hartimin e tyre, me qëllim të zbatimit të ligjit. Ndërsa sa i përket Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, theksoi se ka ardhur në plotësim për shkak të direktivave të BE-së të cilat duhet të inkorporohen në të, dhe se gjatë punës në grup mund të diskutohen këto çështje.

Fatmir Xhelili, lidhur me Neni 40 të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, theksoi se fjala është për shënjimi në mënyrë fizike të kufirit, i cili përcaktohet dhe rrjedh nga një marrëveshje ndërkombëtare. Komisionet e krijuar në nivel shteti për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare e kanë këtë të drejtë, pasi është e ditur që marrëveshjet ndërkombëtare kanë fuqi mbi ligjet ekzistuese, dhe për këtë arsye kërkohen 2/3 për të votuar në Kuvend.

Zoran Mojsilović, theksoi se është konsultuar me grupin parlamentar të Listës Serbe dhe si grup do të kenë amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror. Gjithashtu theksoi që me marrëveshjen mes Prishtinës dhe Beogradit janë përcaktuar disa kalime kufitare dhe është marrë obligim që të mos përdoren simbolet shtetërore (siç janë pikat Jarinje, Bërnjak), prandaj gjatë shqyrtimit të projektligjit do të propozohen amendamente në grupin punues.

Fatmir Xhelili, theksoi që është mirë që propozim-amendamentet të bëhen me kohë dhe është dashur të bëhen gjatë leximit të parë të projektligjit, në mënyrë që grupi punues të mund ti trajtoj.

Ismet Beqiri, theksoi se projektligji do të trajtohet ashtu siç është shkruar për kufijtë shtetëror, ndërsa sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare theksoi se janë të një natyre tjetër.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

VENDIM

- 1. Formohet grupi punues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-214 dhe Projektligjit 06/L-014 për Infrastrukturë Kritike*
- 2. Grupi punues ka këtë përbërje: Fatmir Xhelili-kryesues, Rexhep Selimi, Zoran Mojsiloviq, Xhelal Svecla, Ramiz Kelmendi, Blerim Kuçi, anëtar*
- 3. Grupi punues në bashkëpunim më Njësinë koordinuese të Komisionit të hartojë Planin e punës dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision;*
- 4. Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit punues gjatë punës së tij;*
- 5. Shpenzimet për punën e grupit të punës për zbatimin e këtij vendimi mbulohe nga buxheti i Komisionit, respektivisht nga buxheti i Kuvendit.*

Kryetari, theksoi se Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka shprehur gatishmërinë për të ofruar ndonjë hulumtim ose ofrimin e ndonjë ekspertize në mbështetje të Kryetarit të Komisionit gjatë shqyrtimit të projektligjeve.

4. Të ndryshme.

Kryetari, njoftoi që ka një kërkesë nga ana e KDI-së, për të realizuar një vizitë në pikën kufitare në Merdare, për të parë sa është zbatuar marrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë.

Blerim Kuçi, theksoi se është mirë të përcaktohen prioritetet, dhe propozoi që të shtyhet ky aktivitet për vitin e ardhshëm.

Kryetari, pas propozimeve të anëtarëve të komisionit, theksoi që pajtohen në parim për këtë vizitë, por për kohën do të përcaktohen më vonë.

Gjithashtu njoftoi për takimin e përbashkët në Komisionin për Punë të jashtme, qëllimi i këtij takimi ka qenë që secili Komision të ftoj ministrat e linjës për të raportuar lidhur me zbatimin e marrëveshjeve të arritura në mes të Kosovës dhe Serbisë. Për këtë arsye propozoi që në javët në vazhdim të ftohet në Komision, Ministri i Punëve të Brendshme për të raportuar për këtë çështje.

Fatmir Xhelili, theksoi që pajtohet me propozimin Kryetarit dhe kërkoi që materialet për këtë çështje tu përcillen deputetëve.

Kryetari, propozoi që gjatë raportimit në Komision, Ministri të raportoj edhe për zbatimin e Planit Kombëtar të MSA-së.

Fatmir Xhelili, lidhur me të gjeturat e Komisionit për demarkimin e vijës kufitare me Malin e Zi, i cili është prezantuar në Qeveri, theksoi se do të ishte mirë të organizohej ndonjë dëgjim

publik apo mënyrë tjetër për informimin e deputetëve, lidhur me ato të gjetura që janë të ndryshme nga ato të Komisionit paraprak.

Ismet Beqiri, propozoi që të realizohet një vizitë në Aeroportin e Prishtinës, për të parë situatën e sigurisë.

Blerim Kuçi, theksoi që do të shihen çështjet më me prioritet, siç është çështja e marrëveshjes për demarkimin e vijës kufitare me Malin e Zi. Duke shtuar që Komisioni do të ishte mirë të organizoj një takim me Komisionin për shënjimimin e kufirit, për të kuptuar më nga afër të gjeturat e këtij raporti.

Kryetari, theksoi që nëse nuk do të ketë ndonjë aktivitet nga ana e Kuvendit, Komisioni mund të organizoj ndonjë seancë dëgjimore dhe kjo pas konsultimeve në grupe parlamentare.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Haxhi Shala